



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 529 Më 20.02.2024
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

623-23-2282-2-1-1/C547

KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik: AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K., TRINGË SMAJLI, PRISHTINË, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

Titulli i Kontratës: RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE

Me numër identifikues: **623-23-2282-2-1-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Rregullimi dhe Mirëmbajtja e Hapësirave të Jashtme dhe të Brendshme në Institucionet Publike**

Nr.	Grupi
4	Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë **prej 36 Muajsh**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë: 5 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: **NË OBJEKTET E INSTITUCIONEVE PUBLIKE**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës për njësi është (*Çmimi i përgjithshëm i peshuar*): **765.48 Euro**.

[**Shtatëqindegjashtëdhjetepesë Euro e katërdhjetetë Cent**]

Vlera totale indikative e kontratës është: **120,000.00 Euro.** [**Njëqindenjëzetë mijë Euro**]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fiksë dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veqanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.


Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhen: Shqipe¹ në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues:			
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Smajl Latifi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ / Kryetari i Komunës së Rahovecit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.02.2024	Data:	20.02.2024
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve:	
Emri:	Afrim Sadiki
Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:	
Data:	20.02.2024
Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofroresit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofroresit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofroresit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrore i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofroresi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjese e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofroresi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofroresin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohej në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofroresi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjese të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofroresi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjese të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofroresit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofroresit të Shërbimeve siguruesve të Ofroresit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofroresit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofroresin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitive të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofroresi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofroresi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofroresin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofroresi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofroresit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofroresin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofroresi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofroresi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofroresi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofroresi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofroresi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyë:

- dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofroresi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvçese kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofroresit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 **Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënë të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjetë të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofrcesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* përmashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofrcesit të Shërbimeve, përvçë nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofrcesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershmë të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofrcesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofrcesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të rnoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofrcesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëherëm përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përmbyllur në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofrcesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofrcesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofrcesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve koston ekstra, nëse ka, përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofrcesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofrcesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofrcesi i Shërbimeve

10.1 Ofrcesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofrcesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofrcesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve përmbyllur prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve koston ekstra, nëse Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofrcesin e Shërbimeve përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve koston ekstra, nëse nuk arrin t'i paguajë Ofrcesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofrcesin e Shërbimeve përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve koston ekstra, nëse nuk arrin t'i paguajë Ofrcesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofrcesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përpunje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofrcesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrcesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtrej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofrofuesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmite e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofrofuesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofrofuesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofrofuesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofrofuesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofrofuesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “*Menaxherin e Projektit*”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofrofuesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofrofuesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofrofuesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofrofuesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofrofuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhëni e pjesës së imbetur të shërbimeve. Ofrofuesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofrofuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofriuesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofriuesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofriuesi i Shërbimit

15.1 Ofriuesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuar nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofriuesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofriuesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofriuesi

i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbytjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmes Ekzekutivit që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të siperpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkесës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkесës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoresh, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

623-23-2282-2-1-1/C547

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amendamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i Shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të Shërbimeve: me datën e nënshkrimit të Kontratës
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është në Institucionet Publike të Komunës së Rahovecit
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te përgjithshme te kontratës. Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga Zyrtar Kryesor Administrativ
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: 37 muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	15.1	<p>Reziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Mjetet motorike të Palës së Tretë: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. b) Përgjegjësia e palës së tretë: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. d) Përgjegjësia profesionale: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. <p>Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik.</p>
Parimit e përgjithshme të pagesës	16.1	<p>Pagesa do të bëhet nga ana e Autoriteti Kontraktues për shërbimet e kryera vetëm në bazë të Kërkesave për pagesë do të bëhen për shërbimet e performuara.</p> <p>Pagesat do të bëhen pas dorëzimit të procesit të pranimit të shërbimeve të kryera dhe faturës.</p>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Inspektimi i shërbimeve kryhet nga Menaxheri i projektit i caktuar nga Komuna. Periudha e përgjegjësise së Defekteve është sipas propozimit të Menaxherit të Projektit dhe Komisioni për mbikëqyrje dhe pranim të kryerjes së shërbimeve.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshtë ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjkata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.</p>

Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Shuma me TVSH
1	Furnizimi, transporti, montimi i pllakave të dyshemesë për ambient të jashtëm ose të mbrendshme me trashësi 2 cm dhe me material ngjitus adekuat për hapësira të jashtme. Në pozicion përfshihen edhe punët dhe materialet tjera përcjellëse për montimin e pllakave. Duhet të llogaritet edhe largimi i pllakave të demoluara dhe transportimi deri ne deponi të licencuar. Ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	1	49	49.00 €
2	Furnizimi dhe montimi i pasqyrës, të vendosen në të njëjtin nivel me pllakat për vendet ku do të punohen edhe pllakat, për pozitat ku pllakat janë ekzistuese pasqyra duhet të vendoset me silicon dhe të ketë llajsnë të holla horizontale me fund dhe lart.	m ²	1	85	85.00 €
3	Furnizimi dhe montimi vendosja e pragut të derës nga graniti kuarc 3.0cm	m ²	1	71	71.00 €
4	Furnizimi me material suvatimi i mureve dhe tavaneve. Me suvatim nënkuqtohet mbulimi i sipërfaqeve të mureve dhe tavaneve me llaq-suva. Materialet e përdorura për suvatim mund të janë të ndryshme. Metoda dhe materiali tradicional i cili përdoret akoma është përzierje e zallit, çimentos dhe ujit. Plasimi mund të bëhet me dorë apo makinë automatike me spërkatje. Sipërfaqja e fituar nuk është mjartë rrafshët. Mund të lihet e tillë me një strukturë apo pér rrafshim adekuat rrafshohet edhe me një shtresë patinim-glet. Materialet tjera për suvatim janë materiale të gatshme nga prodhues të ndryshëm me bazë gipsi që përzihet me ujë me makina automatike dhe spërkatje. Sipërfaqet e krijuara janë mjartë të rrafshëta dhe të pranueshme por pér rrafshim të përkryer nevojitet edhe një shtresë e hollë patinuese.	m ²	1	7.8	7.80 €
5	Furnizimi me material dhe punimi, vendosja e këndoreve metalike ne këndet e mureve.	m'	1	2.1	2.10 €
6	Furnizimi me material dhe patinimi gletimi i sipërfaqeve të dëmtuara.	m ²	1	4.9	4.90 €
7	Parapërgatitja e bazës pér shtrimin e ybercugut shtresës nivelizuese estrihut.	m ²	1	2.3	2.30 €
8	Furnizimi dhe punimi i ybercugut shtresës rrafshuese nivelizuese me rramje nga ana e ujëmbledhësve me trashësi prej 5-10 cm varësisht prej pozitës. Ybercugut shtresa nivelizuese estrihut të përbajë fibra kundër plasaritjes.	m ²	1	7.6	7.60 €
9	Furnizimi dhe montimi me material termoizolues stiropor 3cm.	m ²	1	4.3	4.30 €
10	Furnizimi dhe montimi me material termoizolues stiropor 5cm.	m ²	1	5.1	5.10 €
11	Furnizimi dhe montimi me material termoizolues stirodur 3cm.	m ²	1	4.3	4.30 €
12	Furnizimi dhe montimi me material termoizolues stirodur 5cm.	m ²	1	6.3	6.30 €
13	Furnizimi me material, izolime kundër lagështisë, pas nivelizmit bëhet përgatitja e shtresave që duhet izoluar, të përdoret edhe shiriti izolues, së pari lyhet një shtresë me bazë të izolimit, pastaj dy shtresa izolimi të ftohtë, në mure deri në lartësinë prej 0.5 m, ndërsa në vendet ku vendosen lavamanët, pisoaret deri në lartësinë prej 1.20 m, në hapësirat që shfrytëzohen pér dush-dheri në lartësinë prej 2.00 m.	m ²	1	4.1	4.10 €
14	Furnizimi dhe vendosja e pllakave të qeramikës në mure.	m ²	1	27	27.00 €



15	Furnizimi dhe vendosja e këndoreve metalike jo koroduese në pllakat e qeramikës në mure.	m'	1	3.2	3.20 €
16	Furnizimi dhe vendosja e pllaka të qeramikës për dysheme.	m ²	1	26	26.00 €
17	Furnizimi dhe vendosja e këndoreve metalike jo koroduese në pllakat e qeramikës në dysheme.	m'	1	3.2	3.20 €
18	Furnizimi dhe vendosja e pllaka të granitit kuarc.	m ²	1	67	67.00 €
19	Furnizimi dhe vendosja e pllaka të qeramikës (cokla).	m ²	1	41	41.00 €
20	Furnizimi dhe ngjyrosja e mureve me ngjyrë-për ambient të brendshëm dhe rezistente ndaj lagështisë e plastifikuar të klasit të parë sipas ISO Standardeve në dy shtresa apo deri sa te arrihet kualiteti i pranueshëm, paraprakisht të bëhet lyerja me material bazë.	m ²	1	3.4	3.40 €
21	Furnizimi dhe ngjyrosja e plafonëve me ngjyrë-për ambient të brendshëm dhe rezistente ndaj lagështisë e plastifikuar të klasit të parë sipas ISO Standardeve në dy shtresa apo deri sa te arrihet kualiteti i pranueshëm, paraprakisht të bëhet lyerja me material bazë.	m ²	1	3.6	3.60 €
22	Furnizimi dhe ngjyrosja e mureve me ngjyrë yndyrote të klasit të parë sipas ISO Standardeve në lartësi te përcaktuar nga menaxheri prej dyshemesë, paraprakisht të bëhet lyerja me material bazë PVE.	m ²	1	3.6	3.60 €
23	Furnizimi dhe rregullimi ndërrimi i cilindrit të derës.	copë	1	25	25.00 €
24	Furnizimi dhe rregullimi ndërrimi i bagllamës së derës.	copë	1	25	25.00 €
25	Furnizimi dhe rregullimi ndërrimi i gomës së derës.	copë	1	19	19.00 €
26	Furnizimi dhe rregullimi mekanizmit te dritares.	copë	1	35	35.00 €
27	Furnizimi dhe rregullimi bagllamës së dritares.	copë	1	24	24.00 €
28	Furnizimi dhe rregullimi ndërrimi i gomës së dritares.	copë	1	26	26.00 €
29	Furnizimi si dhe rregullimi ne objekte me panele dekorë sipas kerkesë se AK-së	m ²	1	23	23.00 €
30	Furnizimi si dhe rregullimi i pllatose neper kthinan e klasave me parket	m ²	1	12	12.00 €
A	NENTOTALI A:				620.80 €
31	Furnizimi me material epoxod përgatitja e dyshemesë duke përfshirë gjerryerjen me makineri adekuate me disqe të diamantit dhe aspirator për têrheqjen e pluhurit. Punimi i shtresës bazë epoxide EP 304 e përzier me rërë kuarci 0.03-0.07 mm dhe e mbuluar në rërë kuarci të fraksionit të njëjtë. Punimi i shtresës bazë epoxide EP 304 e përzier me rërë kuarci 0.03-0.07 mm dhe e mbuluar ne rërë kuarci të fraksionit të njëjtë.(Përsëritet mirëpo duhet të jetë e pigmentuar me pigmentë). Punimi i shtresës Epoxide Vetnivellizues EP 423 (Mund të përdoren edhe çipsa dekorues). Punimi i shtresës finale Protec 15 15 i cili është mbrojtës i shtresës epoxide (Mund të jetë mat ose gjysmë mat). Trashësia komplete e këtij sistemit është: t=5mm. Punimi i këndoreve-(rathëve) me lartësi 7cm, hark ose thyerje 45 shkallë, që punohet me material epoxid/qualitatur (Mortje).	m ²	1	43	43.00 €



32	Furnizimi me materiali Pu Puluritan. Përgatitja e dyshemesë duke përfshirë gërryerjen me makineri adekuate me disqe të diamantit dhe aspirator për têrheqjen e pluhurit. Punimi i shtresës baze epoxide EP 304 e përzier me rërë kuarci 0.03-0.07 mm dhe e mbuluar në rërë kuarci të fraksionit të njëjtë. Punimi i shtresës bazë epoxide EP 304 e përzier me rërë kuarci 0.03-0.07 mm dhe e pigmentuar me pigmentë). Punimi i shtresës prej Pu, Puluritan PU 1400 (Mund të përdoren edhe çipsa dekorues). Punimi i shtresës finale Protec 15 15 i cili është mbrojtës i shtresës Pu Puluritan (Mund te jete mat ose gjysmë mat). Trashesi komplete e ketije sistemit eshte: t=5mm. Punimi i këndoreve (rrathëve) me lartësi 7cm, hark ose thyerje 45 shkallë, që punohet me materiali Pu Puluritan i quajtur (Mortje).	m ²	1	39	39.00 €
33	Furnizimi, punim dhe montimi i derës nga materiali PVC, ngjyrë te bardhe me profile metalike të brendshme 1.8mm dhe ndërprerje termike. Saldimi të bëhet në temperaturë Optimale 240 C. Mekanizmi i hapjes "Wink Hous" ose tjetër me karakteristika të njëjta, brava HOPE-SEQUESTIC ose tjetër me karakteristika të njëjta, me profil 7.8 cm, min. 5 komora ajri, koef. max i transmetimit te nxehtësisë 1.7W/m2K. Përforcimi me konzola, tiplla dhe bulona adekuat. Materialet e përdorura të janë me standarde DIN, ISO, EN. Duhet llogaritur rregullimi rreth derës pas montimit. Disajni sipas skemave.	m ²	1	105	105.00 €
34	Furnizimi, punim dhe montimi i dritares nga materiali PVC, ngjyrë te bardhe me profile metalike të brendshme 1.8mm dhe ndërprerje termike. Saldimi të bëhet në temperaturë Optimale 240 C. Mekanizmi i hapjes "Wink Hous" ose tjetër me karakteristika të njëjta, brava HOPE-SEQUESTIC ose tjetër me karakteristika të njëjta, me profil 7.8 cm, min. 5 komora ajri, koef. max i transmetimit te nxehtësisë 1.7W/m2K. Si dhe pikorja lamarina e plastifikuar dhe sollobanka nga mermeri d=3cm. Përforcimi me konzola, tiplla dhe bulona adekuat. Materialet e përdorura të janë me standarde DIN, ISO, EN. Duhet llogaritur rregullimi rreth derës pas montimit. Dizajni sipas skemave.	m ²	1	99	99.00 €
35	Vendosja e stoperave për mos përplasjen e derës për pllaka.	copë	1	42	42.00 €
36	Demolimi i dyerve ekzistuese.	copë	1	39	39.00 €
37	Demolimi i dritareve ekzistuese.	copë	1	39	39.00 €
B	NENTOTALI B:				406.00 €
38	Demolimi i kasetave ekzistuese si ujësjellësit elektrike.	copë	1	45	45.00 €
39	Servisimi dhe mbushja e Klimave	copë	1	85	85.00 €
40	Furnizimi dhe rregullimi ndërrimi i cilindrit të derës.	copë	1	35	35.00 €
41	Furnizimi dhe rregullimi ndërrimi i bagllamës së derës.	copë	1	25	25.00 €
42	Furnizimi dhe rregullimi ndërrimi i gomës së derës.	copë	1	18	18.00 €
43	Furnizimi dhe rregullimi mekanizmit te dritares.	copë	1	45	45.00 €
44	Furnizimi dhe rregullimi bagllamës së dritares.	copë	1	35	35.00 €
45	Furnizimi si dhe montimi i Klimes 12000 BTU	copë	1	540	540.00 €
46	Furnizimi si dhe montimi i Klimes 18000 BTU	copë	1	790	790.00 €
47	Furnizimi si dhe montimi i Klimes 24000 BTU	copë	1	940	940.00 €
48	Furnizimi dhe rregullimi i sistemit te fasades strukturore silikote	m ²	1	29	29.00 €



49	Furnizimi dhe rregullimi i lineliumit egzistues	m ²	1	31	31.00 €
50	Furnizimi dhe rregullimi i gilinderave ne objektet egzistuese	m ²	1	41	41.00 €
51	Furnizimi dhe rregullimi i pjeses te demtuara ne pllafonet egzistuese	m ²	1	12	12.00 €
52	Rregullimi dhe riparimi i oxhaqeve te objekteve. Në cmim të përfshihet demolimi dhe largimi i pjesëve të dëmtuara, furnizimi me material të ri (tullë dhe llamrinë) dhe muratimi, montimi (sipas kërkesës së AKsë).	m ²	1	41	41.00 €
c	NENTOTALI C:				2,712.00

TOTALI 3,738.80 €

R E K A P I T U L L I M I :

		Çmimi per njësi i ofertës, pa peshuar në bazë të rëndësisë në €	Peshimi i Çmimit sipas rëndësisë	Çmimi per njësi i ofertës me poentim në bazë të rëndësisë në €
A	Nën totali A : artikujt 1-30	620.80	60 %	372.48
B	Nën totali B : artikujt 31-37	406.00	30 %	121.80
C	Nën totali C : artikujt 38-52	2,712.00	10 %	271.20
Çmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te vleresohej ne baze te kesaj vlere). Kjo është vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike:				765.48

Identifikimi i operatorit ekonomik (OE)

Emri i OE:	AS TECH SH.P.K
Emri dhe mbiemri i perfaqesuesit te OE:	AFRIM SADIKU
Nenshkrimi:	S. Sadiqi
Data:	23.05.2023
Vula:	Prishtina



 Shëderi me Përgjegjësi * AFRIM SADIKU * 23.05.2023 * Prishtina